



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1551/1 prot.

Tiranë, më 22 .12 . 2022

V E N D I M

Nr. 225 , datë 22 . 12 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 191 Regj., datë 05.12.2022, e shtetases E. S, kundër Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me pretendim diskriminimin për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes civile (e divorcuar)” dhe “aftësisë së kufizuar të djalit”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Prej 5 (pesë) vitesh i kam kërkuar në vijimësi z. Gj të më jepet statusi shkencor, të punësohem pranë Akademisë së Shkencave, por nuk më është kthyer asnjë përgjigje dhe nuk më është dhënë asnjë zgjidhje.

Për sa më lart, ndihem e diskriminuar për shkak se jam e divorcuar, kam një djalë më aftësi të kufizuara dhe jam në një gjendje të rënduar ekonomike, pasi jetoj me të ardhurat nga pagesa e invaliditetit të djalit tim D. S”.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, për shkaqet e pretenduara prej saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

- *Lidhur me pretendimin e parë për moskthimin e përgjigjes ndaj kërkesave të saj për marrjen e statusit shkencor dhe punësimin pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (cituar në vijim ASH), Komisioneri vlerëson si më poshtë:*

Subjekti ankues është shprehur se ka paraqitur kërkesa pranë ASH për t'iu njohur statusi shkencor si dhe për t'u punësuar pranë këtij institucioni prej 5 (pesë) vitesh në mënyrë të vazhdueshme, ndërkohë që ka depozituar pranë Komisionerit një kërkesë, e cila referuar kuponit postar është depozituar pranë ASH me datë 30.11.2022 (ankesa pranë KMD-së është regjistruar me datë 05.12.2022).

Ky pretendim i ankueses lidhet me refuzimin e Kryetarit të ASH, për t'iu përgjigjur zyrtarisht kërkesës së saj apo për ta njohur atë me arsyet e refuzimit.

Komisioneri vëren se, mosveprimi institucional i Kryetarit të ASH ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankueses, se institucioni sipërcituar, nuk i është përgjigjur kërkesave të saj; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDMDHP).

Bazuar në nenin 24², të këtij Ligji, KDMDHP, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar.

² *“Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, KDMDHP ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t'u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. KDMDHP merr*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të shtetases E. S për moskthim përgjigje nga ana e Kryetarit të ASH, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj³.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

- *Lidhur me pretendimin e dytë të ankueses për diskriminim të saj nga ana e Kryetarit të ASH, duke mos i njohur asaj statusin shkencor, duke mos i botuar e promovuar veprat e saj, si dhe duke mos i ofruar mundësi punësimi, Komisioneri vëren se:*

Së pari, lidhur me sa më lart, ankuesja nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë që të mund të dëshmonte se ka depozituar pranë ASH dosje me punët e saj shkencore apo datën kur i ka depozituar ato (përveç kërkesës së datës 30.11.2022).

Së dyti, lidhur me pretendimin se është diskriminuar nga Kryetari i ASH, pasi nuk e ka punësuar, ankuesja nuk ka dhënë asnjë informacion se cilat kanë qenë pozicionet e punës për të cilat ka aplikuar, kur janë shpallur apo datat kur ajo ka aplikuar për secilin pozicion të pretenduar që nuk është punësuar (arkiviste, asistente në sektorin e marrëdhënieve me publikun, ndihmës protokolliste etj).

Së treti, lidhur me pretendimet e ankueses kundër Kryetarit të ASH, lidhur me mosnjohjen e statusit shkencor të saj apo mos publikimit e promovimit të librave të saj shkencorë, Komisioneri

vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se KDMDHP nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”.

³ Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

vëren se ankuesja nuk legjitimohet lidhur me këto pretendime, pasi Kryetari i ASH nuk e gëzon një tagër të tillë, bazuar në sa më poshtë:

Ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 2, të tij ka përcaktuar se: *“Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rolit të Akademisë, i organeve përbërëse të saj dhe i atyre që veprojnë pranë saj, si dhe rregullimi i marrëdhënieve të Akademisë me institucionet e tjera të kërkimit shkencor e të politikave të zhvillimit të saj”*.

Në zbatim të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, ka dalë dhe akti rregullator i veprimtarisë botuese të ASH, “Rregullorja e veprimtarisë botuese të ASH⁴”.

Në këtë akt nënligjor përcaktohet se, ASH ka entin e vet botues, që përgatit dhe publikon veprat e miratuara për publikim, me autorë anëtarë të saj dhe /ose personalitete të dijes nga radhët e bashkëpunëtorëve të saj, të cilat miratohen nga Këshilli i Botimeve.

Përbërja e këtij Këshilli përcaktohet në nenin 3, të kësaj Rregulloreje:

“Këshilli përbëhet nga 13-15 anëtarë: kryetari, zëvendëskryetari, dy anëtarë të zgjedhur nga seksionet përkatës, dy përfaqësues të komisioneve të përhershme, një përfaqësues i Akademisë të Rinjve, tre anëtarë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, një përfaqësues nga Ministria e Kulturës (Qendra Kombëtare e Librit) dhe një përfaqësues nga Ministria e Diasporës”.

Lidhur me pranimin e punimeve shkencore, neni 13 i Rregullores përcakton se, dosja e një punimi shkencor që dorëzohet për botim pranë entit botues të ASH, duhet të përmbajë:

“Kërkesën drejtuar Këshillit të Botimeve ose redaksisë përkatëse;

Studimin shkencor të shtypur në format A4 dhe të numerizuar në formatim PDF, në letër dhe në CD. Për botimin në periodikët shkencorë autori paraqet edhe përkthimin në gjuhën angleze; - Deklaratën e autorësisë dhe të origjinalitetit;

Ilustrimet në regjistrim të numerizuar me rezolucion të lartë.

Pranimi bëhet në zyrën e protokollit para mbylljes së vitit kalendarik, bashkë me deklaratën me shkrim që punimi është i përfunduar dhe mund të kalojë menjëherë për shqyrtim e botim. Dorëshkrimi i dorëzuar nuk mund të tërhiqet për të bërë ndryshime.

Dorëshkrimet nuk kthehen. Autori deklaron me shkrim se studimi i tij, ose ndonjë studim i ngjashëm, nuk është duke u shqyrtuar ose nuk është pranuar diku tjetër për botim.

Recensionimi është proces që kryhet nga enti botues. Recensionuesve u ngarkohet të shprehen edhe për mbivendosje mes aplikimeve të ngjashme”.

⁴ Akti rregullator me nr. 209 prot., datë 03.03.2020.

Vendimmarrja për botimin e veprës përcaktohet në nenin 14 të Rregullores, duke ia njohur këtë kompetencë Këshillit të Botimeve, specifikisht:

“Pas shqyrtimit të punimit shkencor dhe të dokumenteve të certifikimit, Këshilli i Botimeve dhe redaksitë shprehen me vendim, që merret jo më vonë se në tremujorin e parë të vitit kalendarik. Pas kësaj nënshkruhet kontrata e botimit me autorin. Redaksitë marrin vendime dy herë në vit”.

Dorëshkrimet e dorëzuara për botim në ASH i nënshtrohen shqyrtimit të hollësishëm të recensionimit sipas procedurave vijuese⁵ dhe shqyrtimi e vendimmarrja për botimin ose jo të tyre, nuk është kompetencë e Kryetarit të ASH. Kështu:

Shqyrtimi fillestar kryhet nga nënstrukturat e brendshme të ASH, për t'u siguruar se dorëshkrimi u përgjigjet programeve të saj të botimit;

Shqyrtimi i mëtejshëm i besohet një redaktori shkencor (*anëtari të këshillit të botimeve ose të redaksisë në rastin e revistave*) për vlerësimin në bazë të kriterëve të botimit; Propozimet për botim vlerësohen minimalisht nga dy recensionues të jashtëm. Caktimi i më shumë recensionëve varet nga redaktori shkencor. Autorësia e punimit/artikullit dhe autorësia e recensionit mund të mos bëhen të njohura në procesin përgatitor. Pas recensionimit, redaktori shkencor i propozon Këshillit të Botimeve/Redaksisë një prej alternativave të mëposhtme:

- Pranimin e dorëshkrimit për botim;
- Pranimin me një rishikim të lehtë;
- Rishikimin e thellë të punimit/artikullit;
- Refuzimin e kërkesës për botim.

Lidhur me sa më sipër, ankuesja nuk depozitoi asnjë provë që ajo kishte dërguar dosje të saj pranë ASH-së, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 13, të Rregullores të ASH-së.

Në nenin 33, pika 4/ç, të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç)*nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”. Për rrejdhojë, Komisioneri gjykon se kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 53/2019 “*Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*”, Asambleja e ASH, në mbledhjen e saj të datës 18.10.2019, miratoi Statutin e këtij institucioni.

Detyrat kryesore të Asamblesë, përcaktohen në nenin 25 të Statutit, ndër të cilat, në pikën 8 të tij, përcaktohet se: “*....Asambleja...përcakton llojet e çmimeve shkencore dhe kriteret e dhënies së*

⁵ Neni 20, i kësaj Rregulloreje.

tyre”. Bazuar në sa më lart, të drejtën për shqyrtimin, vendimmarrjen dhe kompetencën për vlerësimin e dhënien e çmimeve shkencore, bazuar në studimet a veprat e caktuara të autorëve të ndryshëm, e ka Asambleja e ASH, dhe jo Kryetari i ASH.

Në këtë logjikë, nuk legjitimohet pretendimi i ankueses se është diskriminuar nga Kryetari i ASH, lidhur me mosdhënien e mosnjohjen e meritës së saj lidhur me botimin e veprave shkencore të saj, përsa kohë ai si Kryetar i ASH, nuk e gëzon një tagër të tillë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b⁶”, të LMD-së, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues E. S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁶ Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.